



AGRO TEC

EXPO 2022

BUJQËSI - BLEGTORI - KOPSHTARI

Edicioni i 3^{të} | 24-26 Nëntor



AGROTECH EXPO 2022

Edicioni i III-të i Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit dhe Agroteknologjisë AGROTECH Expo 2022, i organizuar nga Expocity Albania, do të zhvillohet në datat 24-26 Nëntor, 2022. Ky panair ofron një platformë komunikimi biznesi për aktorët më të rëndësishëm kombëtarë, rajonalë e ndërkombëtarë, në sektorët e makinerive bujqësore, kimikateve, plehrave kimike, agropërpunimit, konservimit, magazinimit, ambalazhimit, paketimit të produkteve bujqësore dhe transportit, ushqimit organik dhe agroturizmit.



Në një linjë me edicionet e mëparshme, AGROTECH Expo 2022 do të vazhdojë të japë kontributin e vet në zhvillimin e sektorit përmes: komunikimit të suksesshëm mes kompanive, ekspozimit të blerësve potencialë dhe takimeve B2B. Këto kanë për qëllim krijimin e mundësive të reja për prezantimin dhe promovimin e produkteve dhe shërbimeve në sektorin bujqësor, lidhjen e partneriteteve të reja, informimin mbi zhvillimet më të fundit në teknologjinë agrare dhe zhvillimin e politikave sektoriale.

Në sajë të vëmendjes ndërkombëtare, AGROTECH Expo 2022, përmes eventeve të targetuara, forumeve dhe workshopeve informuese dhe edukative, do t'u ofrojë sipërmarrësve lokalë dhe rajonalë, dije dhe ekspertizë mbi depërtimin dhe rritjen në tregje të reja, shkëmbim njohurish specifike mbi sektorin, rrjetëzim, si dhe informim mbi mundësitë e rritjes së biznesit. Në Edicionin e II-të, AGROTECH Expo ka shënuar një rritje prej 45% të numrit të ekspozuesve në total dhe gjithashtu ka tërhequr vëmendjen e pjesëmarrësve nga rajoni dhe atyre ndërkombëtarë.

Që prej Shtatorit 2019, AGROTECH Expo është tashmë event anëtar i EURASCO-s (Federatës Europiane të Panairove Bujqësore dhe Organizuesve të Eventeve) www.eurasco.org.

Forumi AGROTECH Expo 2022

Institucionet shtetërore kryesore, projektet në bujqësi dhe kompanitë lider të sektorit, do të shërbejnë si histori suksesi për potencialin e Shqipërisë në sektorin bujqësor. Në këtë kontekst, AGROTECH Expo 2022 do të mbledhë aktorët kryesorë për të diskutuar mbi çështjet më të rëndësishme që ndikojnë sektorin.

AGROTECH Expo 2022 do të shërbejë si një kanal për shkëmbimin e informacionit, parashtrimin e strategjive dhe nismave për investimet dhe zhvillimet në bujqësi, duke prezantuar mundësitë më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm.

Gjatë Edicionit të II-të të AGROTECH Expo, ne mirëpritëm në Shqipëri konferencën ndërkombëtare "Global G.A.P Stop Tour", e cila pati një ndikim shumë të rëndësishëm në sektorin bujqësor përsa i përket informimit për certifikimet Global G.A.P.





Bujqësia në Shqipëri

Bujqësia është një sektor prioritar në Shqipëri, me një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Bujqësia është burimi kryesor i punësimit, veçanërisht në zonat rurale. Ky sektor gjeneron rreth 20% të GDP-së dhe mundëson 37% të punësimit në total. Sektori bujqësor në Shqipëri po shënon rritje të qëndrueshme duke kontribuar edhe në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto. Kërkesa në rritje për ushqime të shëndetshme, organike, ka rritur ndjeshëm nevojën për përshtatjen ndaj teknologjive më të fundit dhe zgjidhjeve më efektive për transformimin e biznesit në bujqësi, në mënyrë që të rrisë prodhimtarinë dhe t'i përshtatet nevojave të tregut. Industria e agropërpunimit në veçanti, ka patur një rritje të konsiderueshme gjatë 10 viteve të fundit. Ky sektor ka shënuar një rritje prej 3% në xhiron vjetore dhe një rritje prej 3.3% në punësim.

Programi i IPARD II për Shqipërinë u mundëson fermerëve dhe agrobizneseve në Shqipëri aksesin ndaj një fondi prej 71 milionë eurosh nga BE-ja, për periudhën 2014-2022, plus 23 milionë euro që do të mundësohen nga qeveria shqiptare - pra një fond total prej 94 milionë eurosh, i vlefshëm për investimet në bujqësi dhe zhvillim rural, duke inkurajuar kështu fermerët dhe agrobizneset për t'u bërë proaktivë, për të shfrytëzuar mundësinë e dhënë nga fondet e IPARD II dhe për të aplikuar për mbështetje financiare. AGROTECH Expo 2022 do të ofrojë mundësitë më të mira për marrjen e informacioneve të vlefshme për agrobizneset.

Kategoritë e ekspozuesve:

- ▶ Makineri bujqësore, pjesë këmbimi, komponentë
- ▶ Sisteme pompimi dhe sisteme për ujitjen
- ▶ Sera dhe pajisje
- ▶ Sisteme hidroponike
- ▶ Kopshtari, makineri dhe pajisje për prerje, mbjellje dhe korrje
- ▶ Makineri dhe pajisje për kopshtari
- ▶ Makineri dhe pajisje për përpunimin e ullirit
- ▶ Teknologji për agropërpunim
- ▶ Makineri prodhuese dhe përpunuese
- ▶ Kimikate dhe plehra kimike
- ▶ Materiale për shumim
- ▶ Fidanishte
- ▶ Bimë mjekësore
- ▶ Ushqime bujqësore dhe organike
- ▶ Agroturizëm
- ▶ Konservim, magazinim
- ▶ Ambalazhim dhe paketim i produkteve bujqësore
- ▶ Transport
- ▶ Institucione shtetërore
- ▶ Institucione financiare
- ▶ Organizata dhe shoqata bujqësore

Vizitorët:

- ▶ Fermerët
- ▶ Blerësit potencialë
- ▶ Agjentët
- ▶ Kompanitë e eksportit të makinerive dhe pajisjeve bujqësore
- ▶ Distributorët rajonalë të kompanive të importit
- ▶ Shoqatat tregtare bujqësore
- ▶ Investitorët e huaj





Expocity Albania është organizues i Panairove dhe Konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare, i çertifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panairove, ekspozitave dhe eventeve të ndryshme të biznesit, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar.

Expocity Albania ju ofron pjesëmarrësve në këto aktivitete një strukturë dhe infrastrukturë të plotë, bashkëkohore dhe të plotësuar me të gjitha lehtësitë dhe stafin e nevojshëm.

Këto bashkë me 5'500 m² hapësirë të brendshme, 7'000 m² hapësirë të jashtme, 800 vende parkimi, e plotësojnë Expocity Albania si platformën më komplekse dhe më të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij lloj komunikimi në Shqipëri.

Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 6760 66222

+355 (0) 677700077

e-mail: emanuela.hykollari@expocity.al

Info@expocity.al

web: www.expocity.al